

## KONTRATË SHITJE KUOTASH

Ne Permet, sot, me date 31.08.2023 (dymije e njezetetre),

**SHITESI** : ARBER GOGA , shtetas shqiptar, lindur ne Memaliaj, me date 12/06/1983 mbajtes i ID me nr personal I30612021T me banim ne Permet, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar. ( ketu e meposhte do te quhet **(SHITESI)**).

Dhe ,

**BLERES** : Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "InAlba Tour" SH.P.K e regjistruar ne QKB date 16/03/2017 me administrator Andi Dragoj shtetas shqiptar, lindur ne Permet, me date 14/08/1993 mbajtes i ID me nr personal J30814027P me banim ne Permet, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar. ( ketu e meposhte do te quhet **"BLERESI"**).

Palet kerkuan dhe rane dakort per hartimin e kesaj Kontrate Shitjesh Kuotash duke u mbeshtetur ne parashikimet e Kodit Civil te Republikes se Shqiperise si dhe ne Ligjin Nr . 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite Tregtare" sipas kushteve qe vijojne me poshte:

### Ekzistojne keto kushte paraprake

1. Rezulton se shoqeria "QUAD ALBANIA" sh.p.k. eshte person juridik shqiptar regjistruar ne Qendren Kombetare te Regjistrimit (QKR) me date 23/08/2023 dhe pajisur me numer identikimi NUIS - M34423801A, me kapital themeltar prej 10.000 (dhjet mije) Leke.

- i) Ortaket e Shoqerise " QUAD ALBANIA" sh.p.k. jane si me poshte:

MARCO CAVAZZA ME 51% te quotave me kapital 5.100 lek

Dhe

ARBER GOGA ME 49% te quotave me kapital 4.900 lek

- ii) Shoqeria ka si objekt veprimtarie :

Propozime dhe dhenien e mjeteve te motorizuara me qera sipas kontratave te nenshkruara. Shitje te produkteve te ndryshme tradicionale shqiptare dhe propozimin e tyre tek individet dhe te personat juridik brenda dhe jashte vendit. - Organizim dhe kryerje eskursionesh turistike ditore ose



javore, brenda dhe jashtë vendit me mjetet e shoqërisë ose të marra me qera, me shoqëruarit e vet ose me bashkëpunëtor.

- Formulimi dhe shitja e paketave të ndryshme turistike me destinacione të ndryshme brenda dhe jashtë vendit.
- Organizimin dhe kryerjen e transportit të turistëve nga aeroportet ose portet në hotelet ose në destinacionet e dëshiruara sipas prenotimeve dhe sipas klauzolave të kontratave që lidhen me personat fizikë ose juridikë.
- Propozime dhe dhënie të mjeteve të motorizuara me qera sipas kontratave të nënshkruara.
- Shitje të produkteve të ndryshme tradicionale shqiptare dhe propozimin e tyre tek individët dhe te personat juridik brenda dhe jashtë vendit.
- Shitje të paketave turistike, udhëtime, shërbime për transport dhe prenotime hotelesh për të gjithë personat fizikë, juridikë dhe individët.
- Ofrim informacionesh dhe këshilla, planifikim udhëtimesh, organizim udhëtimesh të personalizuar brenda dhe jashtë vendit.
- Përfshihen biletat e transportit për pasagjerë të cilët nuk kanë lidhje me agjencinë e udhëtimeve turistike ose me tur operatorët, me aktivitetet turistike.
- Aktivitet si zyrë informative mbi turizmin lokal dhe mbi strukturat e akomodimit për turistët.
- Aktivitet për guida turistike dhe shoqëruar ose udhërrëfyes turistik.

- Organizim dhe menaxhim të udhëtimeve turistike të shitura nga agjencitë turistike apo nga vetë tour operatorët. Udhëtimet mund të përfshijnë një ose disa nga shërbimet e mëposhtme.:

Transport, akomodim, ushqim, vizita në muzeume dhe në ambiente me interes historik dhe kulturor, evente teatrale, muzikore dhe sportive.

- Organizim dhe kryerje eskursionesh turistike ditore ose javore, brenda dhe jashtë vendit me mjetet e Shoqërisë ose të marra me qera, me shoqëruarët e vet ose me bashkëpunëtorë.
- Organizim eventesh të ndryshme në të gjitha fushat brenda dhe jashtë vendit.
- Shitje të produkteve të ndryshme tradicionale shqiptare dhe propozimin e tyre tek individët dhe te personat juridikë brenda dhe jashtë vendit.

Përshkrimi i objektit të shoqërisë ka natyrë indikuese dhe jo kufizuese. Për realizimin e qëllimit të saj shoqëria mund të bashkëpunojë me çdo person fizik, juridik, publik apo privat në çdo mënyrë që e gjykon të dobishme. Shoqëria në çdo kohë mund të ripërcaktojë objektin e saj, ta shtojë apo pakësojë atë, me vendim të asamblese së shoqërisë.

- iii) Në datë 31.08.2023 ortakut i shoqërisë "QUAD ALBANIA" sh.p.k, Arber Goga me 49% të kapitalit ka vendosur shitjen e këtij kapitali me vlerë 4.900 leke që përfaqëson 49% të kapitalit themelues të Shoqërisë, kjo në favor të blerësit InAlba Tour shpk.



- iv) Nga ky moment, "InAlba Tour" SH.P.K zoteron 1(nje) pjese me vlere 4.900 leke, qe perfaqeson 49% te kapitalit themeltar te Shoqerise Quad Albania.

## NENI 1

### Objekti i Kontrates

- 1.1 Objekti i kesaj Kontrate eshte shitja e kapitalit themeltar te Shoqerise, me vlere 4.900 (katermije e nenteqinde) leke, qe perfaqeson 49% te kapitalit themeltar.

## Neni 2

### Cmimi i shitjes

- 2.1 Palet, bien dakort qe cmimit total i shitjes se ketyre kuotave do te jete si me poshte .
- 2.2 Duke nisur nga neni 2 shitesi eshte dakort dhe me vullnet te lire i shet bleresit 1 (nje) pjese te kapitalit themeltar te shoqerise qe eshte e barabarte me vleren e 4.900 (katermije e nenteqinde) Leke dhe qe perfaqeson 49% te kapitalit themeltar te shoqerise. Palet deklaruan se pagimi i cmimit te shitjes eshte kryer plotesisht nga bleresi, sot ne daten e hartimit te kesaj Kontrate.

## Neni 3

### Kalimi i titullit te pronesise

- 3.1 Kalimi i titullit dhe pronesise behet nga casti i kalimit te kuotave, deri ne castin e rregjistrimit te kalimit , sipas pikes 2 te ketij neni.
- 3.2 Shoqeria regjistrimin e kuotes , sipas nenit 43 te ligjit nr 9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" . Regjistrimi i kalimit te kuotave ka efekt deklarativ.
- 3.3 Nje kopje e kesaj kontrate shitjeje do te depozitohet menjehere prane Qendres Kombetare Te Bisnesit, (QKB) ne menyre qe te behet kalimi i menjehershem i kuotave ne pronesi te bleresit.

## Neni 4

### Te Drejtat dhe detyrimet e shitesit

- 4.1 Shitesi mori persiper, te njoftoje, garantoje dhe siguroje Bleresin se deri ne momentin e lidhjes dhe te nenshkrimit te Kontrates se mesiperme keto kuota :

- Nuk jane objekt i ndonje konflikti gjyqesor.





- Nuk janë të bllokuara për llogari të të treta.
- Shitesi është pronar ligjor dhe nuk ka persona të tjere të këne pretendime në lidhje me këto kuota.
- Dokumentacioni i bashkangjitur i kësaj Kontrate , është origjinal, ligjor dhe nuk është marrë në rrugë të kundraligjshme apo falsifikuar.

## Neni 5

### Te drejtat dhe detyrimet e Bleresit

- 5.1 Që nga momenti i nënshkrimit të kësaj kontrate, Bleresi do paguaje çdo lloj takse mbi kapitalin që ai zoteron në shoqëri, detyrimet ndaj të treta , shteti etj...
- 5.2 Bleresi ka të drejtë që të sillet si pronar i ligjshëm mbi këto kuota nga momenti i nënshkrimit të kësaj kontrate.
- 5.3 Bleresi angazhohet të mbaje në emrin e vet kuotat që do të përfitojë nga kjo kontrate shitje kuotash.

## Neni 6

### Zgjidhja e Kontrates

- 6.1 Palet nuk mund ta zgjidhin kontrate në mënyrë të njëanshme përveç kur kemi mos përmbushje të detyrimeve.
- 6.2 Asnjë nga palet nuk ka të drejtë të bëjë ndryshime në kontrate në mënyrë të njëanshme. Për çdo problem që mund të lindë, apo ndryshim i domosdoshëm i kontrates i diktuar nga kushtet konkrete të vendit apo legjislacionit, palet do të infromojnë njëri tjetrin në adresat përkatëse me shkrim dhe vetëm pasi kanë rënë dakort mund të realizojnë ndryshime në kontrate.

## Neni 7

### Interpretimi i Kontrates në teresi

- 7.1 Cdo kusht apo formulim që mund të sjellë paqartësi do të interpretohet në kontekstin e teresise së Kontrates dhe në këndvështrimin e qëllimit që i shtyu palet të lidhin këto Kontrate.



A large, stylized blue ink signature or scribble is located in the bottom left corner of the page.

## Neni 8

### Legjislacioni i zbatueshem dhe juriksioni

8.1 Kjo kontrate shitje, me objekt Shitje kuotash , eshte hartuar ne baze te legjislacionit shqiptar dhe konkretisht te Kodit Civil te Republikes se Shqiperise si dhe Ligji Nr.9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare"

8.2 Te gjitha mosmarrveshjet qe mund te lindin nga interpretimi ose zhatimi i kushteve te kesaj Kontrate , jan objekt shqyrtimi dhe gjykimi para Gjykates se Rrethit Gjyqesor Gjirokaster.

## Neni 9

### Njoftimet

9.2 Cdo njoftim, kerkese apo cdo lloj komunikimi nepermjet paleve do te behet me shkrim ne adresat e pershkruara ne kete Kontrate duke patur paraysh qe te dergohet sa me shpejt.

## Neni 10

### Gjuha e Kontrates

10.1 Kontrata hartohet ne 3 kopje te njejta ne gjuhen shqipe.

### SHITESI

Arber Goga

### BLERESI

InAlba Tour shpk

Andi Dnagaj

